The Ergotherapist

Instituti Kosovar i Ergoterapisë	www.kosovoergotherapists.com	www.WFOT.org

Copyright © 2019 JEC Educational

Përmbajtja

- Spiritualiteti dhe Ergoterapia
- Përvoja ime në Gjermani si profesionist shëndetsor nga Kosova
- Certifikatën e Parë të Regjistrimit naga INKET
- Gjërat që dëshiroj t'i kisha ditur si e diplomuar - 30+ vjet më vonë!!!
- Na duhen vullnetarë që të na ndihmojnë me aktivitete të ndryshme
- 8 terapitë më të suksesshme për trajtim të Autizmit
- Aftësitë motorike për funksion
- Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional (ZHVP)
- Research – Pencil Grasp, Legiblity and Muscle Activation
- Mendimi i Stuart-it

-

Komiteti i Revistes "Ergotherapist"

Kryeredaktore – Dr. Jennifer Caldwell
Përkthyese – Sr Teuta Augustini
Gazetare – Greta Gjata

Spiritualiteti dhe Ergoterapia

Duke e rilexuar artikullin *"A practical Approach to Spirituality"* nga Mary Ann McColl, PHD, MTS, më lindi dëshira ta bashkëndajë me ju thelbin e porosisë së saj më shkurtimisht dhe në gjuhën shqipe.

Si ta integrojë ergoterapeuti aspektin shpirtëror në praktikë? Janë zakonisht dy mënyra se si klientët na tregojnë që kanë probleme funksionale të lidhura me dimensionin shpirtëror, ajo direkte dhe indirekte. Disa e shprehin haptas besimin e vet ose bindjet religjioze, praktikimin e fesë personale e të bashkësisë së vet fetare, si dhe raportin e vet me Zotin apo Fuqinë hyjnore. Të tjerët e hapin këtë muhabet duke i përmendur disa simbole të besimit të vet ose duke shtruar pyetje rreth kuptimit të jetës, jetës pas vdekjes, arsyen pse disa gjëra ndodhin në jetë, shprehin humbjen e shpresës ose besimit.

Ekzistojnë së paku katër mënyra se si ergoterapeuti mund t'i qaset klientit i cili direkt ose indirekt do ta hapë temën në lidhje me spiritualitetin ose përshpirtërinë personale.

1. Pavarësisht prej eksperiencës dhe përkatësisë fetare si dhe njohurive të cilat i posedon një ergoterapeut, ai/ajo duhet të jetë i përgatitur **të dëgjojë klientin dhe t'i njeh** simbolet, fjalët, temat të cilat klienti mund t'i përdorë për të folur rreth aspekteve shpirtërore. Autorja thotë se do të ishte turp nëse ergoterapeuti nuk do të ishte në gjendje të vlerësojë thellësinë dhe rëndësinë e çështjes shpirtërore të cilën klienti dëshiron ta ngritë dhe e injoron apo nuk e vëren fare.
Edhepse diskutimet mbi spiritualitetin kërkojnë një shkallë të konsiderueshme të kompetencës kulturore, ne si ergoterapeutë nuk kemi nevojë të dimë për çdo religjion për të qenë në gjendje të flasim me dikë për përshpirtërinë e tij. Këto çështje shpirtërore mund të shqyrtohen me anë të koncepteve të përgjithshme, duke pyetur për raportin e tyre me Fuqinë më të lartë, ku e vënë ata shpresën për të ardhmen e tyre, ku e gjejnë kuptimin e jetës, a i përkasin ndonjë komuniteti fetar.
Ne zakonisht hasim në dy vështirësi. Së pari, nuk kemi fjalor apo koncepte adekuate për t'u përgjigjur bindshëm dhe me profesionalizëm, dhe së dyti, kemi frikë mos po ua imponojmë klientëve bindjet tona personale.
Edhepse këto janë shqetësime të arsyeshme, ne mund t'u qasemi klientëve me një thjeshtësi duke e pranuar thellësinë dhe rëndësinë e asaj që ata bashkëndajnë me ne dhe t'i pyesim nëse dëshirojnë ta diskutojnë këtë gjë edhe më tutje.

2. E dyta gjë që ergoterapeuti mund të bëjë është t'i ofrojë klientit që **t'ia gjejë dikë kompetent** për një bisedë të thellë shpirtërore. Këta mund të jenë zyrtarët fetar nga komuniteti të cilit i përket klienti, ose kapelani multi-religjioz, të cilët punojnë nëpër spitale, qendra shëndetësore e sociale. Ta drejtosh klientin tek këshilltari fetar mund të jetë kontribut i fuqishëm terapeutik për klientin i cili ka probleme të natyrës shpirtërore.

3. **Ndërhyrja shpirtërore indirekte** është mundësia e tretë të cilën ergoterapeuti mund ta përdorë për klientët tek të cilët dyshojnë se çështjet shpirtërore po ndikojnë në angazhimet e tyre.

Nga literatura e shoshitur dalin gjashtë modalitete ose mënyra për të ofruar mundësinë për diskutim ose bisedë në lidhje me eksperiencën shpirtërore, e që në vete nuk janë shpirtërore ose religjioze: ajo narrative, rituale, vlerësimi i natyrës, kreativiteti, puna, lëvizja.

4. Mundësia e katërt është **ndërhyrja shpirtërore direkte**, siç janë lutjet, meditimi ose këshillimi shpirtëror, si dhe praktikat specifike fetare. Këto ndërhyrje apo intervente kërkojnë trajnime dhe kualifikime shtesë dhe shumica e ergoterapeutëve mund të ndihej se këto çështje janë jashtë interesimit dhe praktikës së tyre, përveç nëse kanë tashmë ndonjë përgatitje apo certifikatë.

Si përfundim, ekzistojnë shumë mundësi për ergoterapeutët për ta pranuar dhe respektuar dimensionin shpirtëror të klientëve të tyre. Ergoterapeutët ndryshojnë për nga interesi në këtë fushë të praktikës ose sa ata ndihen rehat me këto opsione dhe nuk duhet turpëruar për shkak të kësaj. Turp do të ishte të mos jenë në gjendje ta njohin vuajtjen shpirtëroe të klientëve të tyre, ose ta njohin e të mos dinë se çka të bëjnë ose të ndërmarrin.

Sikurse autorja shpreson, le të jetë ky artikull i shkurtër ndihmë për ergoterapeutët jo vetëm të identifikojnë problemet shpirtërore, por të jenë të aftë edhe të ndihmojnë duke e kuptuar e pranuar problematikën, t'u referohen profesionistëve tjerë të kësaj fushe, t'u japin klientëve mundësi të shprehjes dhe eksplorimit shpirtëror përmes metodave terapeutike të njohura dhe në fund, në raste të shqyrtuara me kujdes, të bashkëndajnë praktikën shpirtërore me klientët e tyre.

https://occupationaltherapycafe.com/2016/05/08/a-practical-approach-to-spirituality/

Teuta Augustini
Ergoterapeute

Përvoja ime në Gjermani si profesionist shëndetsor nga Kosova

Gjermania ka nevojë për profesionistë shëndetsor për fusha të ndryshme, mirëpo procedurat e njohjes së kualifikimeve janë të gjata dhe burokratike, të cilat marrin kohë shumë. Kam filluar punën në një Spital Komunal, në Erding, si infermier në Bavarinë e Epërme, pasiqë mungesa më e madhe që ka Gjermania momentalisht, janë infermierët. Ndoshta nuk është profesioni ideal pasi që kam studiuar Ergoterapinë, por për shkak të leje qëndrimit ka qenë më e lehtë. Në Gjermani vlen shumë përvoja praktike, të cilen ke arritur ta bësh duke studiuar dhe punuar. Para se të vija këtu kam kërkuar mundësi tjera për të emigruar, por ka qene shumë e veshtirë për shkak të izolimit politik, mungesës së lëvizjes së lirë pa viza.

Fillimi këtu nuk ka qenë i lehtë, pasi që ka një dallim të madh të mënyres se si punohet këtu dhe në Kosovë, sa i perket fushës së Infermierise. Dokumentimi është një element shumë i rëndesishëm në Gjermani për shkak të sigurimeve shëndetsore, andaj çdo kujdes shëndetsor i ofruar ndaj pacientit duhet të dokumentohet. Pastaj rëndësi të madhe ka edhe higjiena e personelit, posaqërisht dezinfektimi i duarëve dhe puna higjienike me doreza gjatë kujdesit të ofruar.

Higjiena e pacientit dhe kujdesi ndaj higjienes trupore të pacientëve ka rëndësi shumë të madhe si dhe ndihma apo mbështetja ne aktivitietet e vetëkujdesjes, mirëpo gjithmonë duke shfrytëzuar resurset të cilat pacienti i ka në dispozicion. Sfidë tjetër ishte gjuha dhe jo gjuha gjermane në përgjithësi, por gjuha profesionale e cila do një angazhim intensiv dhe me shumë përkushtim, për të arritur qëllimet profesionale në fushën në të cilen synohet. Tani jam duke ju përkushtuar gjuhës profesionale dhe jam duke pritur vendimin mbi njohjen e Ergoterapisë, një procedurë e cila zgjat dhe cila pritet të kryhet brenda 3 muajve.

Një njohje direkte e kualifikimeve nga vendet e treta jashtë Bashkimit Evropian, është pothuajse e pamundur, vetëm në qoftë se dëshmohet një përvojë e gjatë e punës në profesionin gjegjës p.sh në Ergoterapi, ju mund të merrni një njohje direkte. Kjo ndodh në qofte se keni mbi 10 vite përvoje pune, gjë që është shumë e veshtirë të arrihet në Kosovë për të gjithë, pasi qe Ergoterapia është një profesion i ri dhe duhet investime për të krijuar vende të reja pune. Duke iu referuar kësaj na duhet akoma shumë punë për të arritur nivelin e edukimit në Gjermani, sepse edhe kushtet në të cilat punohet duhet përmirsuar, për të ju përshtatur nevojave të tregut të punes në vendet e Bashkimit Evropian.

Alban Xhemali Ergoterapeut - Gjermani

Certifikatën e Parë të Regjistrimit nga INKET

Instituti Kosovar i Ergoterapisë ka nderin të ndajë për ***Greta Gjatën***, Certifikatën e Parë të Regjistrimit nga INKET. Greta Gjata është një nga Ergoterapeutet e para në Kosovë që plotësoi të gjitha kërkesat për të fituar lejën e punës nga Oda e infermierëve dhe Profesionistëve Tjerë të Shëndetit.

Ajo përfundoi me sukses studimet në drejtimin BSc Ergoterapi, në Kolegji Heimerer, ndërmori 6 muaj praktikë në spitale dhe klinika private dhe kaloi me sukses provimin e licensës.

Gjithashtu urojmë edhe ***Suzana Gashi dhe Pranvera Ramabaja*** të cilat morën licensën e tyre të punës. Certifikatat e tyre do publikohen në muajt e ardhshëm të Ergotherapist.

Numër 0001

Instituti Kosovar i Ergoterapisë

Kjo Certifikatë konfirmon se

Greta Gjata

ka përfunduar me sukses punën praktike
të kërkuar për BSc. Ergoterapi

dhe

ka kaluar provimin e licensës

Një kopje e këtij regjistrimi do të ruhet në regjistrat e

Institutit dhe do të jetë i disponueshëm në web-faqen
https://www.kosovoergotherapists.com

Rina Hajdaraga – Udhëheqëse

Dr Jenifer Caldwell – Themeluese

20 anar, 2020

Gjërat që dëshiroj t'i kisha ditur si e diplomuar 30+ vjet më vonë !!!

Duke shikuar mbrapa pas 30+ vjetësh, them se është një bekim kur i shoh të gjitha sfidat që u hodhën në rrugën time, të cilat më kanë bërë terapeute që jam sot. Këto janë gjërat që kam mësuar:

Të mos jesh i përvuajtur - Kam parë kaq të diplomuar të rinj me master dhe doktoraturë duke hyrë me kokat e mbajtura lart, duke vepruar thuajse ata i dinë të gjitha, të cilët kanë qenë të përulur nga një asistent i ergoterapisë me përvojë.

Mos pranimi i gabimeve - një hap drejt përvujtërisë. Nuk do të mësoni kurrë nëse vazhdoni të mohoni se keni bërë gabime. Në fakt kjo ju bën më të fortë dhe më të mirë. Mbaj mend që bëra splintin e tmerrshëm për të cilin mendoja se ishte mjaft i mirë. Epo, terapisti mbikëqyrës i profesionit e pa atë të nesërmen dhe pyeti se kush e bëri atë splint. Unë pranova që e bëra vetë, dhe ajo më dha një kurs të shkurtër se si të formoja mirë një splint.

Mos mësimi nga gabimet - Ju jeni një i diplomuar i ri. Ju nuk i dini të gjitha. Shumica e gjërave do të jenë të reja. Me gjëra të reja vijnë edhe gabimet. Kjo është e pashmangshme. Mësoni prej tyre. Sfidohuni. Po i rikthehem kursit tim të shkurtër mbi splintet. Vite më vonë, unë mora një kompliment nga asistentja jonë e ergoterapisë se sa kam përparuar në aftësitë e mia të bërjes së splinteve që nga ai splinti fatal i gabuar.

Mos bërja e pyetjeve - Ju jeni i ri. Ju nuk dini gjithçka. Kështu që, PYETNI!!! Bërja e pyetjeve nuk është shenjë e inferioritetit. Është shenjë që ju kujdeseni mjaftueshëm për standardet tuaja të kujdesit. Se dëshironi më të mirën, jo vetëm nga ju por për pacientët dhe bashkëpuntorët tuaj. Mbaj mend që kam marrë pjesë në mbledhjet e departamenteve për të përfaqësuar departamentin e ergoterapisë, dhe muaj pas muaji jam marrë në pyetje në lidhje me buxhetin. Si një nga terapeutët më të rinj, unë nuk mund të përmbaja kureshtjen time dhe pyeta se cili ishte buxheti? Me sa duket, askush nuk guxoi të pyeste drejtorin deri atëherë. Por, ai u detyrua dhe më dha një kopje. Që nga atëherë, departamenti i ergoterapisë ishte në buxhet dhe e bëri një Drejtor të lumtur Rehabilitimi.

Mos kërkimi i ndihmës - Ju jeni i ri. Ju nuk dini gjithçka. Pra - Kërkoni ndihmë!!! Në muajin tim të parë si ergoterapeute në Skoci, unë kisha një rekomandim për të vlerësuar një burrë të moshës së mesme me një krah protetik. Ishte një nga ato që nuk kisha parë, dhe nuk dija të operoja. Unë thjesht munda t'ia jepja një terapeuti tjetër, por atë ditë unë isha e bekuar. Nga ndihmësi im i

ergoterapisë zbulova se një nga ergoterapeutët e njohur të profesionit që specializohen në Ortopedi dhe Prostetikë punonte në të njëjtin spital. Kështu që, unë e takova dhe, djalo, vërtetë mësova shumë. Në fillim, isha e frikësuar, por kur ajo erdhi dhe filloi të më mësonte me pasion, kjo më mësoi për përvujtërinë dhe për atë se çka ishte ergoterapia – e kjo ishte që t'i bëja njerëzit e tjerë më të mirë!!!

Mos dëshira për të mësuar gjëra të reja - Ju jeni një i diplomuar i ri. Ju nuk keni parë gjithçka. Mos u turpëroni nga mundësitë për të mësuar. Mund të jenë kushte ose diagnoza të reja, mjete të reja ose pajisje të reja, dhe ambiente të reja pune ose role dhe pozita të reja. Asnjë terapeut nuk fillon duke i njohur të gjitha kushtet. Mësimi është një proces i vazhdueshëm. Kam punuar për 30+ vite dhe ende mësoj gjëra të reja çdo ditë. Një herë, unë e pata pacientin tim të parë me amputime bilaterale mbi gju. Nuk dija shumë për amputimet dhe ia shpreha këtë pacientit tim. Sidoqoftë, i thashë që do të mësoja më tepërrreth amputimeve. Shkurtimisht, pas 3 muajsh. I njëjti pacient më dëgjoi duke u shpjeguar studentëve në lidhje me amputimet e gjymtyrëve të poshtme dhe ia shkrepi: "Wow, ju tingëlloni si një eksperte e amputimeve dhe karrocave!" Të gjitha ato studime u paguan!!!

Marrja e gjërave personalisht - Sjelljet e pacientit kryesisht kanë të bëjnë me kushtet e tyre. Nuk ka të bëjë me ju. Ata do të thonë dhe bëjnë disa nga gjërat më të këqija, por ju duhet të qëndroni të fortë dhe duhet të dini se si të de-stresoheni dhe të krijoni mekanizmat e duhur të bashkëpunimit. Në rastin tim, duke punuar me fëmijë, unë kam qenë kafshuar, goditur, goditur me shuplakë, grushtuar, shqelmuar, pështyrë, urinuar dhe njollosur. Asnjërit prej tyre nuk ia kam ndërprerë terapinë. Të gjithë ata tani janë fëmijë me sjellje më të mirë. Kjo gjithashtu, ka të bëjë me sjelljet e bashkëpuntorëve dhe kolegëve tuaj. Bëhet fjalë për streset e punës dhe jo për ju.

Duke harruar se nuk jeni më në Kolegj - Gjëja më e shkëlqyeshme në lidhje me Kolegjin është që gjithmonë ka një shtytje për të hapur botën dhe horizontet tuaja. Fatkeqësisht, bota e punës, biznesi dhe rregulloret komplotojnë kundër kësaj. Si një i diplomuar i ri, unë kisha ambicie që doja të bëja, vetëm për t'u ndalur nga rregullat dhe rregulloret e korporatave. Mund të kisha hequr dorë atëherë, por ekziston një mënyrë për ta kapërcyer atë, dhe kërkon kohë, hulumtim dhe mësim në lidhje me modelin e biznesit të profesionit tuaj. Kjo përfshin të mos harrosh zinxhirin e komandës në organizatën në të cilën je ose standardet dhe etikën tënde profesionale.

Mos ta zotërosh - Një nga këshillat më të mira që më dha një mentor i mirë i terapisë. Është karriera juaj, integriteti juaj, etika juaj e punës dhe standardet tuaja, kështu që zotëroni ato. Kur të filloni të veproni ashtu që ta zotëroni praktikën tuaj, atëherë do të bëni atë që është e nevojshme për ta bërë këtë profesion të lulëzojë. Ju nuk do të mësoni duke thënë, "Kjo nuk është puna ime". Ju do të kujdeseni për veten tuaj dhe të kujdeseni për vendin tuaj të punës dhe të kujdeseni për mjetet tuaja të tregtisë. Ju do të punoni në një nivel të lartë standardesh.

Terapia nuk ka të bëjë me Terapeutin - Ka të bëjë me klientin tuaj. Një individ nuk bëhet më i mirë për shkak të një terapeuti të mirë. Individi bëhet më i mirë sepse një terapeut krijon mundësitë e duhura për të nxjerrë ato potenciale që ai person ka në radhë të parë.

Dr Jennifer Caldwell

PhD; PG Medical Educaiotn; PG Business Studies; Justice of the Peace

Përktheu: M. Teuta Augustini

Na duhen vullnetarë që të na ndihmojnë me aktivitete të ndryshme si:

- **Promovimi i Ergoterapisë – profesionit tuaj!**
- **Duke iu treguar njerëzve se si mund t'i ndihmojë Ergoterapia**
- **Prezantime në shkolla dhe organizata tjera**
- **Ju mund të sillni ide të reja në grup!!!**

Përfitimet e të qenit vullnetar:

- Ndiheni të vlerësuar dhe pjesë e një ekipe
- Fitoni vetëbesim dhe vetëvlerësim
- Fitoni aftësi të reja, njohuri dhe përvojë
- Zhvilloni aftësitë ekzistuese dhe dije
- Pasuroni CV tuaj
- Përmisoni përspektivat tuaja të punësimit
- Përdorni aftësitë dhe njohuritë tuaja për të ndihmuar tjerët.

Për tjerët, vullnetarizmi ka përfitime sociale si:

- Takimi me njerëz dhe shoqëri të re
- Shansë për t'u socializuar
- Njohja me komunitetin lokal.

Nëse jeni të interesuar ju lutem kontaktoni:

Arlinda Cannolli - inket.volunteers@gmail.com

Ju mund të leni takim me Arlinden për të diskutuar se si mund të ndihmoni, sim und të bëheni vullnetarë ose vetëm të diskutoni rreth projekteve potenciale. Ju mund të shkruani në gjuhën gjermane, angleze dhe shqip.

Ju mund të leni takim me Arlinden për të diskutuar se si mund të ndihmoni.

8 Autism Therapies

Këto janë terapitë, për të cilat prindërit raportuan se po rezultojnë pozitivisht për fëmijët e tyre, të rradhitura në bazë të përqindjes së përmendjes:

1 Ergoterapi – 39%
2 Logopedi – 27%
3 Terapia ABA – 15%
4 Klasët e aftësive sociale – 8%
5 Hipoterapia (Ergoterapia përmes kalërimit) – 2%
6 Dieta GFCF – 2%
7 Sesionet Psikiatër/ Psikolog – 2%
8 RDI, PECs, Noti, PRT (Secila 1%)

Detajet : https://www.autismspeaks.org/blog/top-8-autism-therapies-reported-parents

The Open Journal of Occupational Therapy



The Open Journal of Occupational Therapy është një revistë me qasje të hapur, me një mision për të botuar artikuj me cilësi të lartë që përqendrohen në hulumtimin e aplikuar, praktikën dhe arsimin në profesionin e Ergoterapisë.

https://scholarworks.wmich.edu/ojot/

Semitronix HOTEL

Sapo të mbërrini ju do të merrni një mikpritje të ngrohtë nga ekipi ynë i vëmendshëm dhe i bukur, i cili do të jetë më shumë se i lumtur t'ju ndihmojë të zgjidhni dhomën e duhur.

Dhomat tona janë të dizajnuara për të akomoduar çdo nevojë tuaj dhe shërbimi në dhomë është në dispozicionin tuaj 24 orë, në mënyrë që të mund të trajtoheni për mëngjes në shtrat ose drekë në ballkonin tuaj të gjerë.

Dhoma për fjetje

Restaurant

Dhoma për konferenca

Relaksohuni!



Udhëtimi juaj për relaksim dhe mirëqenie totale, fillon në katin e 9-të të Hotelit tone, ku ju pret një vend unik dhe spektakolar, që përfshin pishinë të mrekullueshme, dhomë masazhesh, sauna dhe palestër.

Str. Lidhja e Pejes
Pristina, Kosovo
Tel: +383 (0) 38 740 222

WFOT 2022 Congress, Paris France

Kongresi tjetër dhe Ekspozita Ndërkombëtare e WFOT, do të mbahet në Paris, Francë, 27 - 30 Mars 2022.

Tema është 'Professional R-Evolution', dhe programi do të përfshijë ekspertë kryesorë në botë, ngjarje unike sociale dhe një ekspozitë, të gjitha të organizuara brenda dhe përreth Qendrës së Konventave të Parisit. Kongresi WFOT 2022 do të jetë edhe një herë ngjarja kryesore në kalendarin ndërkombëtar për ergoterapeutët. Ne mezi presim t'ju shohim në Paris!

Ndiqni të gjitha lajmet e fundit rreth Kongresit WFOT 2022 në Facebook.

EUROPRINTY group
SH.P.K. TIRANË - PRISHTINË

A1 Block, Calabria, Pristina

+386(0)49 556 000

info@europrinty.net/sales@europrinty.net

Europrinty Ltd. është një grup i kompanive që kanë qenë gjithmonë të orientuara drejt punës në një mënyrë të përqendruar, duke pasur të drejta ekskluzive të shitjes nga prodhuesit e njohur për produktet për zyra dhe ato shkollore, furnizimet dhe pajisjet e IT-së dhe industrinë e shtypit.

Gama e produkteve po zgjerohet çdo ditë dhe në vitet e fundit kemi përfshirë linjë të ndryshme të shpërndarjes për lodra edukative, veshje dhe pajisje për udhëtime.

Ofron 3% zbritje

të prodhimeve për

Institutin Kosovar të Ergoterapisë

shop-europrinty.com

TWIN computers

Prishtina

Isa Boletini Nr. 174, Prishtinë

Tel +386 49 826 111 / +381 38 728 051
E-mail **shpendselimaj@gmail.com**

15% zbritje për

Instituti Kosovar të Ergoterapisë

Aftësitë motorike për funksion

Kuptimi i zhvillimit dhe aftësive themelore që përbëjnë një kuptim funksional është hapi tjetër. Nuk ka shumë informacione, mirëpo janë disa hulumtime që përcaktojnë se çfarë përbën një kuptim funksional. Hulumtimi i përfunduar nga Feder & Majnemer (2007) identifikoi aftësitë e mëposhtme si të nevojshme për përdorimin e kontrollit efikas të lapsit: aftësitë e manipulimit në dorë, rotacioni dhe vetëdija shqisore në gishta. Sipas hulumtimeve të përfunduara nga Case-Smith (1993), u gjet që aftësitë e manipulimit në dorë që kërkojnë stabilizimin e parakrahit dhe kyçit të dorës, lëvizje të kontrolluara të brendshme dhe qendrim stabil të gishtit të madh në kundërshtim me gishtat tjerë, për të lejuar gishtat tjerë të lëvizin lirshëm. Në foto tregohet një përshkrim themelor për zhvillim. Faza qëndrojnë në bark dhe faza e zvarritjes ndërtohen mbi njëra-tjetrën për të shtuar përbërës që çojnë në saktësi dhe lëvizshmëri të duarve. Ndonjëherë hapat anashkalohen. Herë të tjera, fëmijët nuk luajnë mjaftueshëm lojëra që zhvillojnë aftësitë fine motorike dhe motorike në përgjithësi.

Mund të ketë gjithnjë e më shumë incidenca të ekraneve dhe teknologjisë që ndërpresin rrugën në këtë piramidë. Dhe kur kjo të ndodhë, fëmijët humbasin disa zhvillime bazike.

Një bazë e krijuar dobët, rezulton me detyra të pasigurta të nivelit të lartë.

Copyright © 2019 JEC Educational

Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional (ZHVP)

Konsumatorët e shërbimeve të Ergoterapisë kanë të drejtë të presin që ergoterapeutët të ofrojnë shërbime në një mënyrë kompetente dhe bashkëkohore, që përmbush standardet më të mira të praktikës.

Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional (ZHVP) është mënyra se si mund të mësoni dhe zhvilloheni profesionalisht gjatë gjithë karrierës tuaj, duke siguruar që aftësitë dhe njohuritë tuaja janë të bazuara në evidencë, në mënyrë që të mund të praktikoni në mënyrë të sigurt. **ZHVP** është një proces interaktiv për të ruajtur dhe zgjeruar njohuritë, ekspertizën dhe kompetencën tuaj si dhe është një komponent i rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve të sigurta dhe efektive, pasiqë vetëm diploma juaj BSc nuk është e mjaftueshme për vazhdimin e praktikës së sigurt. Jo çdo vend do të pranojë kualifikimin tuaj themelorë. Juve mund t'ju duhen prova për studime të mëtutjeshme ose orë praktike, përveç kësaj duhen edhe 1.000 orët praktike të kërkuara nga WFOT, nga kualifikimi juaj BSc. Çdo ergoterapeut do të duhet të ndërmarrë hapa për të ruajtur dhe demonstruar kompetencë të vazhdueshme profesionale. **Kështu që Instituti Kosovar i Ergoterapisë është duke përgatitur një portofol aktivitetesh dhe do të ofrojë mundësi të vazhdueshme të zhvillimit profesional në formën e rasteve studimore dhe aktivitete të tjera mësimore - me një vlerësim të dhënë për individët që paraqesin punën e tyre së bashku me përgjigjet "Shembull" për të përmirësuar te mesuarit.**

Këto aktivitete të **ZHPV**-së do të sfidojnë njohuritë tuaja ekzistuese nga kualifikimi juaj BSc, do të rrisin besimin tuaj, riafirmojnë kompetencën tuaj profesionale ndërsa ju inkurajoheni të reflektoni në praktikën tuaj profesionale dhe zhvillimin.

Nëse jeni i/e diplomuar dhe doni të zhvilloni njohuritë dhe kompetencat tuaja, ju lutemi kontaktoni INKET në emailin info.inket@gmail.com

Research

PENCIL GRASP, LEGIBILITY AND MUSCLE ACTIVATION

A recent study was published on pencil grasp, legibility and muscle activation. The researchers evaluated differences in the handwriting characteristics of thirty-four 18-22-year-old subjects when using the four primary handwriting grip styles: dynamic quadrupod, dynamic tripod, lateral quadrupod, and lateral tripod.

Methodology of the Study

All of the participants completed three protocols involving tests of handwriting legibility on paper. Consistency and metric testing were performed using surface electromyography (EMG) to measure the activity of 6 muscles involved while handwriting on a digital writing tablet to measure stroke duration, length, velocity, and pen pressure. Each individual used each of the four grip styles with all protocols, and scores were normalized to their native grip scores.

Results of the Study on Pencil Grasp, Legibility and Muscle Activation

Following data analysis the researchers discovered that:
•females had a lower range in legibility scores than males.
•pencil grasp style did not impact legibility.
•for muscle activation the upper trapezius was more active in the lateral grips compared to dynamic tripod grip
•the dynamic tripod grip had more extensor carpi ulnaris activity than the lateral tripod grip.

The researchers **concluded** that females are likely to be able to use any grip style with little effect on legibility, but males' legibility scores may drop more.The elevated upper trapezius activity possibly indicates that the lateral grip styles involve more whole-arm, stabilizing movements. The increased extensor carpi ulnaris activity may indicate that dynamic grip pencil grasp styles require a high degree of dexterity movements.

Reference: Farris, K; Fehrenbacher, R; Hayes, E; McEvoy, R; Smith, A; and McCulloch, R (2019) "THE RELATIONSHIP BETWEEN MUSCLE ACTIVATION AND HANDWRITING QUALITY WITH DIFFERENT GRIP STYLES,"International Journal of Exercise Science: Conference Proceedings: Vol. 8 : Iss. 7, Article 57



INSTITUTI KOSOVAR I ERGOTERAPISË

Kemi nevojë për Vullnetarë
Dëshironi të ndihmoni me aktivitete të tilla si ngjarje të promovimit në qendrat tregtare, shkolla, etj?

Ju lutemi të kontaktoni:
Rina Hajdaraga ose Drenusha Rogova,
për më shumë informacion.
Ju mirëpresim të gjithë!

Bashkohu me ne në Facebook

rinahajdaraga@live.com
drenusharogova@icloud.com

www.kosovoergotherapists.com

E RËNDËSISHME

Nëqoftëse e njihni dikë që dëshiron të marrë një kopje të The Ergotherapist, ju lutem më dërgoni detajet e më poshtme.

Kjo është mënyra që ju të tregoni se çfarë mund të arrijë PROFESIONI JUAJ.

Emri i personit:

Email adresa:

Profesioni:

Vendi i punës:

Falënderojmë të gjithë ata që na kanë dërguar detajet kontaktuese muajin e kaluar!